

KLUBI BËHU BURRË

Bëhu burrë ndrysho rregullat

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Bëhu burrë
ndryshoni rregullat

CARE International Balkans ka fituar reputacion për punën e saj në zhvillimin e të rinjve, barazinë gjinore, parandalimin e dhunës me bazë gjinore, fuqizimin e grave dhe mobilizimin e komunitetit brenda projektit Iniciativa e Burrave të Rinj (YMI). Nga 2006-2020, ajo ndërmori një iniciativë të guximshme për të angazhuar meshkuj të rinj (të moshës 15-19 vjeç) dhe nga 2013 femra të reja, në adresimin e dhunës dhe praktikave të dëmshme të maskulinitetit në bashkëpunim të ngushtë me organizatat lokale partnere.

mundësuar nga:

kbb

Filozofia udhëzuese e YMI është që djemtë duhet të kuptohen jo si pengesa për paqen dhe barazinë gjinore, por më tepër si aleatë vendimtarë në promovimin e marrëdhënieve dhe komuniteteve të shëndetshme, jo të dhunshme. YMI mendon se nëse nxënësit mësojnë rreth dhunës, si dhe si të vënë në pyetje normat dominuese gjinore dhe nëse kanë një shans për të praktikuar këto ide dhe aftësi të reja në hapësira të sigurta, atëherë ata do të kenë një gjasë më të madhe për të internalizuar këtë informacion i cili, me kalimin e kohës, do të rezultojë në jetesë më të barabartë gjinore, mënyra të shëndetshme dhe jo të dhunshme të jetës. Për më tepër, ndërsa normat e grupeve fillojnë të ndryshojnë, programi ndihmon në nxitjen e një mjedisi më tolerant, pranues në nivelin e shkollës. Kjo trajektore ndryshimi përmes së cilës djemtë dhe vajzat praktikojnë dhe brendësojnë ide të reja mbështetet nga disa struktura mbështetëse, por më të rëndësishmet janë **Klubet BËHU BURRË**.

Klubet Bëhu Burrë krijohen si klube të nxënësve të shkollave të mesme të cilët janë të angazhuar në një mënyrë kreative në hartimin dhe zbatimin e fushatës "Bëhu burrë" dhe përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të saj. Anëtarët e Klubit janë pjesëmarrës aktivë dhe promovues të fushatës "Bëhu burrë" në mënyrën që ata janë ata që zhvillojnë dhe organizojnë aktivitete të fushatës në shkollat e tyre dhe inkurajojnë të rinjtë e tjerë që të përfshihen në promovimin e vlerave të tyre. Atyre u lejohej të ndërtojnë vetë dhe të inkurajojnë të tjerët të jenë më të mirë, duke siguruar një zonë të sigurt për të rinjtë, ku nuk ka gjykim, mendim të sfiduar dhe ku inkurajohen dialogu dhe mendimi autokritik. Përveç kësaj, ata marrin pjesë në aktivitete motivuese të tilla si mbrëmje filmi, teatër, koncerte, lojëra sportive, udhëtime dhe takime me të rinj të tjerë dhe shkëmbim përvojash me ta përmes llojeve të ndryshme të kampeve rinore dhe kampeve për udhëheqësit e të rinjve.

Bëhu burrë
ndryshoni rregullat

KLUBI BËHU BURRË

Bëhu burrë ndrysho rregullat

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Klubet Behu Burrë nuk janë klube që përfshijnë vetëm burra të rinj, këto klube përfshijnë njëloj burra dhe gra, me qëllimin për të ndërtuar mënyra të shëndetshme jetese për të gjithë ata.

"Ishte mjaft normale të shikoja përlëshje të kurditura në oborrin e shkollës, fytyrat e dikujt tjetër në baltë, të mbuluara me mavijosje. Ishte gjithashtu normale të mos bëja asgjë për këtë dhe të regjistroja gjithçka në telefon ... Disa vjet më vonë, pasi fillova t'i edukoj të tjerët kundër gjërave të këqija në të cilat kam marrë pjesë, kuptova se ekzistonte një jetë tjetër, një jetë më e mirë, në të cilën unë isha personi që i ndihmonte të tjerët dhe që i tregonte atyre një mënyrë më të mirë"

Nikola, Beograd



Sot, ka:

34 Klube BB

30 qytete

2631 të rinj dhe të reja

"Kur u bashkova me Klubin Bonu Burrë në Shqipëri, nuk mund ta imagjinoja që do të më ndihmonte në mënyrë të konsiderueshme në jetën time të përditshme dhe rutinën. Dikur reagoja emocionalisht dhe impulsivisht pa menduar për pasojat. Pas anëtarësimit në Klub, familja ime vuri re ndryshimin në sjelljen time dhe ndërsa ditët po kalonin, miqtë e mi filluan të reagojnë pozitivisht dhe pohuan gjithashtu ndryshimin. Kjo ishte shumë inkurajuese për të dëgjuar! Në Klub, mësova shumë se si të shpreh emocionet e mia në një mënyrë të shëndetshme dhe si të kontrolloj mendimet dhe reagimet e mia fillestare."

Krista, Tiranë



"Para se të anëtarësohesha, mendimin i parë për frazën "Bëhu burrë" ishte "mos qaj" dhe "mos godit një vajzë", por tani e kuptoj që të jesh burrë nuk do të thotë të jesh më i forti në botë dhe të fshehësh emocionet, por kjo do të thotë që burrat duhet të jenë ata që janë pa turp dhe frikë, dhe se nuk është e turpshme të tregosh ndjenjat e tua dhe të jesh ajo që je."

Ružica, Mostar



KONTAKTONI

Për më shumë informacion na kontaktoni përmes info@youngmeninitiative.net


<https://youngmeninitiative.net/en>

<http://care-balkan.org/>

<https://www.facebook.com/youngmeninitiative>

<https://www.instagram.com/yminiinitiative>

Mbështetur nga:



With funding from
Austrian
Development
Cooperation



Partnerët:

